



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 21.03.2023

Nr: 30

Ora: 12:30

V E N D I M

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 35, DATË 17.03.2023 TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR
“LËVIZJA PËR ZHVILLIM KOMBËTAR”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 21.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia “Lëvizja Për Zhvillim Kombëtar”, përfaqësuar nga
z. Fabian Topollari

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 173, datë 14.03.2023 të Komisionerit
Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike
“Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për
zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 123/1, 124, 134-136 të ligjit nr. 10019,
datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të
ndryshuar

Rrethanat e çështjes:



1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.
2. Partia politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Dashamir Shehi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me anë të vendimit nr. 173, datë 14.03.2023 vendosi *regjistrimin e partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, me Kryetar z. Dashamir Shehi, me shkronjat nistore “L.ZH.K”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.*
4. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore nr. 35 partia politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, në datën 17.03.2023, ku pretendojnë se:
 - Në kërkesën për regjistrim si subjekt zgjedhor, ne kemi paraqitur si emër zyrtar të partisë emrin “Aleanca Progresiste LZHK”, emër ky që nuk përputhet me emrin e partisë në vërtetimin e regjistrimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 24.02.2023 ku si emër figuron “Lëvizja Për Zhvillim Kombëtar”;
 - Në bazë të vendimeve të organeve vendimmarrëse të partisë, emri i partisë është ndërruar më 16.02.2023 dhe është depozituar në Gjykatë me datë 02.03.2023, çështje ende ne gjykim;
 - Neni 64, pika 2, e Kodit Zgjedhor e kërkon vërtetimin e regjistrimit të partisë në Gjykatën e Tiranës vetëm për të provuar personalitetin juridik të subjektit zgjedhor, jo për të përcaktuar emrin e partisë politike. Vendimi i ndryshimit të emrit i jep efektet në momentin e hyrjes në fuqi dhe jo në momentin e regjistrimit në regjistër;
 - Në bazë të nenit 35, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “...cilido ka të drejtë të mbrojë dhe të kërkojë ndreqjen e të dhënave të veta personale” fakti që ndryshon emri i partisë politike nuk çënon interesin e garës elektorale ose subjekteve të tjerë zgjedhorë;
 - Ne kërkojmë regjistrimin e partisë “Aleanca Progresiste LZHK”, si subjekt zgjedhor me emërtimin e ri, me shkronjat nistore “L.ZH.K”, i konsideruar i ndryshuar menjëherë sipas Statutit të Partisë sonë.

5. Kërkesa ankimore iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Elvis Çefa. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 21.03.2023, ora 12:30.
6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën ankimore nr. 35, datë 17.03.2023,
 - Vendimin nr. 173, datë 14.03.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,
 - Statutin e Partisë Politike “Aleanca Progresiste LZHK”,
 - Vërtetimin gjyqësor të rrethit gjyqësor, Tiranë nga regjistri i partive politike, datë 24.02.2023.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Neni 64, i Kodit Zgjedhor përcakton në pikën 2, të tij listën e kërkesave që duhet të plotësojë partia politike që dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje, me qëllim që të regjistrohet si subjekt zgjedhor. Analizën juridike të kësaj dispozite, KAS-i e ka zhvilluar në vendimin e tij nr. 27, datë 16.03.2023, i cili është i vlefshëm në thelb edhe për vendimmarrjen lidhur me kërkesën ankimore nr. 35.
2. KAS-i ka çmuar në vendimin nr. 27, datë 16.03.2023, se dokumentacioni shoqërues i kërkesës së partisë politike për regjistrimin në zgjedhje ka karakter në thelb deklarativ dhe nuk formon kusht për përjashtimin e subjektit nga zgjedhjet. Dokumentacioni shoqërues pasqyron vullnetin e lirë të subjektit kërkues. Tek ky vullnet, si rregull, KQZ-ja nuk mund të ndërhyjë, prandaj procedura administrative e shqyrtimit të kërkesës kufizohet, si rregull, në verifikimin nëse dokumentacioni është i plotë dhe nëse i përgjigjet kërkesave taksative të ligjit.
3. Ankuesi ka kërkuar që të regjistrohet në zgjedhjet e datës 14.05.2023, me emrin e ri të partisë “Aleanca Progresiste LZHK”, emër të cilin organet drejtuese kompetente të saj kanë vendosur ta përdorin nga data 16.02.2023, e në vijim. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka refuzuar këtë kërkesë, me arsyetimin se ky nuk është emri i partisë i regjistruar në regjistrin e partive politike, sikurse del nga vërtetimi gjyqësor i paraqitur në zbatim të shkronjës “a” të

nenit 64, të Kodit Zgjedhor. Për këtë arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se emri i ri nuk mund të përdoret në marrëdhëniet zyrtare nga ankuesi.

4. Administrimi nga KQZ-ja i vërtetimit të paraqitur në zbatim të shkronjës “a”, të nenit 64, të Kodit Zgjedhor ka vlerë vetëm për të identifikuar subjektin kërkues dhe për të verifikuar nëse ai ka zotësi për të vepruar, për pasojë, nëse legjitimohet në të drejtën për të kërkuar regjistrimin në zgjedhje. Ky dokument është një akt zyrtar, i nxjerrë nga një regjistër zyrtar (Regjistri i Partive Politike që administrohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë), i cili merret dhe disponohet nga subjekti, por subjekti nuk ka asnjë mundësi të modifikojë sipas dëshirës përmbajtjen e tij. Kodi Zgjedhor kërkon që vërtetimi të lëshohet për të provuar se partia politike është e regjistruar në regjistrin e partive. Ky është qëllimi i vërtetimit. Gjithçka tjetër që përmban teksti i tij është informacion shtesë, por që nuk ka lidhje me kushtin e përcaktuar nga shkronja “a”, e pikës 2, të nenit 64, të Kodit Zgjedhor, i cili konsiderohet i plotësuar, me depozitimin e vërtetimit.
5. Për efekt të regjistrimit në zgjedhje, të dhënat identifikuese janë ato që deklaron subjekti. Nëse midis tyre dhe të dhënave që përmban vërtetimi gjyqësor ka mospërputhje, atëherë KQZ-ja është e detyruar të hetojë se mos këto mospërputhje vijnë për shkak se ndodhemi përpara një subjekti me identitet tjetër, të ndryshëm nga ai që figuron i regjistruar në gjykatë, apo subjekti është i njëjtë dhe të dhënat e vërtetimit gjyqësor janë të paazhornuara. Për të dhëna të paazhornuara, KQZ-ja nuk mund të vendosë përjashtimin e subjektit nga zgjedhjet. Nga dokumentacioni provues i kërkesës ankimore rezulton se, nuk mund të ngrihen dyshime lidhur me identitetin e ankuesit, si dhe lidhur me vazhdimësinë institucionale nga subjekti me emrin “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” tek “Aleanca Progresiste LZHK”.
6. Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar parashikon në nenin 14, se dispozitat e këtij ligji për regjistrimin e partive politike janë njëlloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në regjistrimet e mëparshme. Por ky ligj nuk ka asnjë penalitet për mosazhornimin e të dhënave në regjistër. As Kodi Zgjedhor nuk parashikon penalitete për mosazhornim të të dhënave. Hendeku prej rreth 2 javësh midis datës së miratimit të emrit të ri të partisë me datën e depozitimit të kërkesës për regjistrimin e ndryshimeve në gjykatë nuk mund të trajtohet si mosveprim i kryer me faj dhe i penalizueshëm për ankuesin.
7. Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar parashikon në nenin 12, se *“...emri i një partie duhet të jetë i dallueshëm qartë nga ai i partive të tjera ekzistuese. Inicialet*

dhe emblemat e partive politike nuk duhet të përputhen”. Ky kusht ligjor verifikohet nga gjykata në momentin e regjistrimit fillestar ose, sipas rastit, në momentin e regjistrimit të ndryshimit të emrit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë ende nuk e ka kryer këtë verifikim për emrin e ri të ankuesit. Por regjistrimi në zgjedhje i ankuesit, me emrin e preferuar prej tij, nuk paragjykon dhe as pengon gjykatën në ushtrimin e lirë dhe fuqiptotë të tagrave të veta, në momentin që gjykata do marrë në shqyrtim kërkesën e ankuesit për regjistrimin e ndryshimit të emrit në regjistrin e partive politike. Sikurse regjistrimi në zgjedhje nuk rrezikon që të shkaktojë përplasje identiteti me subjekte të tjera zgjedhore.

8. KQZ-ja e ka obligim të vetin që të verifikojë “nëse dy parti politike ose koalicione kanë emër ose emblemë të njëjtë apo të ngjashme në atë masë sa që mund të shkaktojë konfuzion ose lajthitje të votuesve...” (neni 66 i Kodit Zgjedhor). Në seancën e KAS-it u pranua nga të dy palët se rreziku i konfuzionit apo lajthitjes së votuesve nuk ekziston për emërtimin “Aleanca Progresiste LZHK” për asnjërin nga 46 partitë politike dhe 2 koalicionet e regjistruara në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 143, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 35, datë 17.03.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”.
2. Ndryshimin e vendimit nr. 173, datë 14.03.2023, “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
3. Detyrimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të regjistrojë partinë politike “Aleanca Progresiste LZHK”, me Kryetar z. Dashamir Shehi, me shkronjat nistore “L.ZH.K” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Elvis ÇEFA	-	Relator	(Kundër)
Elvin LAKO	-	Anëtar	
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar	
Koli BELE	-	Anëtar	
Ledio BRAHO	-	Anëtar	